*Calculated anomalies values of evaporation for the June month 2022 (mm/month).*



Referuar dhe vlerave të përlogaritura të avullimit të paraqitura në shkallë kontinentale në figurën Nr.33 si dhe situatës së thatësirës për zonën e Ballkanit; siç shihet hapësira e Shqipërisë duhet thënë u ndodh në kushte mjaft më të mira se pjesë të tjera të vendve jo shumë larg vendit tonë, ku vlerat e treguesit të thatësirës shënuan vlerat më të larta. Situata e thatësirës paraqitet në hartën e dhënë me vlerat e treguesit SPI për muajin qershor 2022 në figurën Nr.35. Në figurën Nr.36 paraqiten të dhënat e avullimit për disa vendmatje meteorologjike në Shqipëri, ndërsa në figurën Nr.37 jepen të dhënat për treguesin e shumës së temperaturave aktive të ajrit mbi pragu 10°C.

Referring to the values calculated on the continental level of evaporation showed in the figure Nr. 33, as well as the drought situation for the Balkan area, as seen in the area of Albania, it should be said that it is happening in much better conditions than other parts of the countries not far from our country, where the value of the indicator of droughts marked the highest values. The drought situation is presented in the map given with the values of the SPI indicator for the month of June 2022 in figure No.35. Figure No.36 shows the evaporation data for some meteorological stations in Albania, while Figure No.37 shows the data for the indicator of the sum of active air temperatures above the 10°C threshold.



*Figure Nr.35 - Vlerat e treguesit të SPI për muajin Qershor 2022 në territorin e Ballkanit. / The values of SPI Index in the Balkan area for the June month 2022.*






Figure Nr.36. – Vlerat e llogaritura të avullimit për muajin qershor 2022 për Shqipërinë.  
The calculated values of evaporation for Albania for June month 2022.





Figure Nr.37. – Vlerat e treguesit të Shumës së Temperaturave Aktive mbi pragun  $10^{\circ}\text{C}$  për muajin Qershor 2022 për Shqipërinë.  
The values of the Sum of Active Temperature above the threshold  $10^{\circ}\text{C}$  for Albania for June month 2022.

Gjatë muajit qershor 2022 në shkallë vendi u vrojtuan dhe zjarre, por duhet thënë se ato ishin në vatra të kufizuara dhe nuk përbënë ndonjë problematikë të rëndësishme.

During the month of June 2022, fires were observed throughout the country, but it must be said that these were in limited areas and did not constitute any important problems.



Për situatën e pritshme të zjarreve gjatë muajve të verës, duke patur parasysh dhe vlerësimet për ndryshimet klimatike në paraqitjen e figurës Nr.38 jepet një informacion se si pritet të ndryshojnë treguesit për këtë dukuri për vitet që vinë.

For the expected situation of fires during the summer months, taking into account the estimates for climatic changes in the presentation of figure No.38, information is given on how the indicators for this phenomenon are expected to change for the coming years.

## Energjitë e rinovueshme


Energjia elektrike e përftuar nga kovertimi i rrezatimit diellor në elektricitet nëpërmjet paneleve diellore mundëson uljen e shpenzimeve energjitike si në nivel individual ashtu dhe komunitar.

Në këtë kontekst në figurën Nr.39 bëhet një paraqitje skematike se si funksionon një gjë e tillë. Për muajin qershor në vijim në figurën Nr.40 paraqitet harta me vlerat e rrezatimit diellor që ofrohen nga natyra dhe klima e Shqipërisë dhe potenciali përkatës.

## Renewable Energy

The electrical energy obtained from the conversion of solar radiation into electricity through solar panels enables the reduction of energy costs both at the individual and community level.


In this context, figure No.39 shows a schematic representation of the function of such a thing. For the following month of June, figure No.40 shows the map with the values of solar radiation provided by the nature and climate of Albania and the potential.





Ky është muaji kur shënohen vlerat më të larta të këtij potenciali.

This is the month when the highest values of this potential are recorded.






Figure Nr.41. – Vlerat e rrezatimit diellor (në W/m²) për muajin qershor 2022 për vendmatjen meteorologjike të Shkodrës në VP të Shqipërinë.

The values of solar radiation (in W/m²) for the meteorological station of Shkodra in NW of Albania for the June 2022.

Në ditët e sotme teknologjitë e fundit tregojnë se paraqiten me një efektivitet të rritur panelet që shfrytëzojnë të dy anët si dhe ndjekin lëvizjen e diellit në të dy akset, të cilët mundësojnë për po të njëjtën sipërfaqe toke të zënë, një rendimet që arrijnë deri mbi 40% më të lartë kundrejt atyre vetëm me një anë. Në figurën Nr.42 paraqiten pamje me disa raste të përdorimeve të këtyre sistemeve fotovoltaike.

Nowadays, the latest technologies show that the panels that use both sides and follow the movement of the sun on both axes are presented with increased effectiveness, which enable, for the same occupied land surface, an arrangement that reaches over 40% higher compared to single sided ones. Picture No.42 shows some examples of the use of these photovoltaic systems.




Figure Nr.42. - Panele diellore që shfrytëzojnë rrezatimin diellor në të dy anët.

Bifacial solar panels that use the solar radiation from both sides.

Gjithashtu duhet evidentuar fakti që dhe kostot e moduleve dyfaqeshe kundrejt viteve më parë tashmë janë pothuajse barazuar me ato të paneleve konvencionale.

Duke mbajtur parasysh dhe disa konsiderata teknike meteorologjike këto sisteme që shfrytëzojnë të dy anët e tyre e përmirësojnë më tej performancën, në se synohet të rritet albedo e sipërfaqes së tokës pranë vendosjes së paneleve.

Kjo ndihmon në rritjen e rrezatimit difuz, i cili mund të sigurohet si në rastin kur përzgjidhen toka me ngjyrë të hapur, ranore, etj, apo kur sipërfaqja e tokës shtrohet me materiale me ngjyrë të hapur si gurë (çakëll i bardhë) ashtu dhe kur kjo gjë sigurohet nga natyra me shtresën e dëborës në periudha të caktuara të vitit.

It should also be noted that the costs of double-sided modules compared to years ago are now almost equal to those of conventional panels.

Taking into account some technical meteorological considerations, these systems that use both sides further improve the performance, if it is intended to increase the albedo of the earth's surface near the placement of the panels.

This helps to increase the diffuse radiation, which can be ensured both in the case when light-colored soils, sandy, etc. are selected, or when the surface of the soil is paved with light-colored materials such as stones (white gravel) and when this is provided by nature with the layer of snow in certain periods of the year.



## Ndryshimet Klimatike

Gjatë muajit qershor në vitet e fundit duhet thënë se në mënyrë të qëndrueshme janë vërtetuar dhe ruajtur anomali pozitive të temperaturave të ajrit. Në shkallë vendi këto tregues paraqiten në figurën Nr.43 (a,b,c).

Për temperaturat mesatare të ajrit rezultojnë një anomali me +2.5°C, ndërkohë që shihet dhe në paraqitjen grafike dhënë në figurën Nr.43 anomalinë më të lartë e kryeson muaji qershor 2022 me +4.1°C. Natyrisht shmanget më të larta i takojnë vlerave të temperaturave maksimale të ajrit, të cilat arrijnë gjatë këtyre viteve me +3.4°C, ku gjithashtu kryeson qershori 2022 me +5.2°C. Sa i takon vlerave minimale edhe ato kanë ndjekur ecuritë e mësipërme, por me një diferencë më të vogël kundërjet normës. Vlerat e anomaliave të temperaturave minimale në shkallë vendi kanë rezultuar gjatë këtyre 6 viteve të fundit kanë qenë në madhësinë +1.6°C, ndërkohë kryeson me shmanget më të lartë qershori 2002 me +3.0°C.

## Climate Change

During the month of June in recent years, it must be said that positive air temperature anomalies have been consistently observed and maintained. At the country level, these indicators are presented in figure No.43 (a,b,c).

For average air temperatures, an anomaly of +2.5°C results, while as can be seen in the graphic representation given in figure No.43, the highest anomaly is headed by the month of June 2022 with +4.1°C.

Of course, the highest deviations correspond to the values of the maximum air temperatures, which reach during these years with +3.4°C, where June 2022 also leads with +5.2°C. As for the minimum values, they also followed the above trends, but with a smaller margin compared to the norm. The values of

minimum temperature anomalies on a national scale have resulted during these last 6 years to have been +1.6°C, while June 2002 leads with the highest deviation




Figure Nr.43. -Vlerat e anomaliave të temperaturave mesatare (a), maksimale (b) dhe minimale (c), gjatë 6 viteve të fundit (2017÷2022) për muajin Qershor për Shqipërinë krahasuar me vlerat e normës.

Values of mean temperatures anomalies (a), maximal (b) and minimal (c) during the last 6 years (2017÷2022) for the June month for Albania compare to norm values.

with +3.0°C.

Sa i takon reshjeve dhe treguesit të ditëve me reshje situata paraqitet me anomali negative në mbarë vendin.

Në vijim në paraqitjet grafike të dhëna për këto dy tregues në figuren Nr.44 dukshëm dallohet situata më e theksuar e rënies së vlerave të ditëve me reshje me vlerë -9.3% kundrejt asaj të lartësisë së reshjeve për territorin e Shqipërisë, që ka shënuar madhësinë -5.1%.

Regarding rainfall and the rainy days index, the situation is presented with negative anomalies. In the following, in the graphic representations given for these two indicators in figure No.44, the most pronounced situation of the decrease is that of days with precipitation by the value of -9.3%, which is clearly distinguished compare to that of the height of precipitation for the territory of Albania, which marked the value of -5.1%.




Figure Nr.44. – Anomalitë e reshjeve dhe ditëve me reshje për muajin Qershor (2017÷2022).  
Anomalies of rainfall and rainy days for the June month (2017÷2022).



## Meteorologji & Histori

Atlasi Klimatik i Shqipërisë (figurën Nr.45), një vepër e rëndësishme në lidhje me vlerësimin e klimës së vendit tonë u realizua nga një grup autorësh dhe u publikua në vitin 1988 nga Instituti Hidrometeorologjik i Akademisë së Shkencave.

Në këtë vepër fillimisht paraqitet harta me ndarjet e zonave dhe nënzonave klimatike të Shqipërisë. Më pas përfshihen një sërë hartash dhe informacionesh të tjera grafike për elemente të ndryshëm klimatik siç janë: temperaturat e ajrit, lartësia e reshjeve atmosferike dhe numrit të ditëve me reshje mbi pragje të ndryshme, ditët me dëborë dhe shtresë dëbore, zgjatja e diellëzimit, rastisja mesatare e erës në % dhe shpejtësitë e saj sipas drejtimeve në m/sec, lagështinë e ajrit, temperaturat e tokës, vranësirat, trysninë atmosferike, etj.

Në këtë kontekst nga ky atlas u përzgjedh dhe paraqitet në figurën Nr.46 harta e kohëzgjatjes së treguesit të diellëzimit me vlerat mesatare shumevjeçare për Shqipërinë.

Në hartë evidentohet zona e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë me vlerat më të larta të diellëzimit, ku shënohen deri në 2800-3000 orë me diell në vit.





Figure Nr.45



The Climate Atlas of Albania (figure No.xx), an important work regarding the assessment of the climate of our country, was done by a group of authors and published in 1988 by the Hydrometeorological Institute of the Academy of Sciences.

In this work, the map with the divisions of climatic zones and sub-zones of Albania is presented first.

Then a series of maps and other graphical information for different climatic elements are included such as: air temperatures, the height of atmospheric precipitation and the number of days with precipitation above different thresholds, days with snow and snow layers, the sunshine duration, the average probability of wind in % and its speed according to directions in m/sec, air humidity, soil temperatures, cloudiness, atmospheric pressure, etc.

In this context, from this atlas, the map of the duration of the sunshine indicator with the multi-year average values for Albania was selected and presented in figure No.46.

The map shows the area of Western Lowland of Albania with the highest values of sunshine, where up to 2800-3000 hours of sunshine per year are recorded.

### Paleoklimatologji

Nga e periudhat akullnajore apo epoka e bronzit e deri në shekujt fundit, në një analizë të imët dhe bazuar në një sërë hulumtimesh në këtë libër në dy volume autori Emmanuel Le Roy Ladurie, është përpjekur dhe ka arritur me sukses të pasqyrojë ecurin e klimës dhe luhajtjet e saj, të cilat natyrisht nuk kanë kaluar pa impakte në civilizimet e kohës.

Ndryshimet e vrojtuar në zhvillimet e bujqësisë në kohëra të ndryshme, luftërat, nga optimumi mesjetar klimatik deri në periudhat e shkurtra akullnajore, fundi i periudhes së fundit akullnajore, e shumë e shumë aspekte të tjera, ku gërshetohen një sërë informacionesh arkeologjike, të pyjeve, vreshtave apo ato historike mundësojnë vlerësime dhe përfundime mjaft të rëndësishme për të gjykur dhe analizuar mbi baza më të sakta shkencore ecurinë e klimës në vitet e fundit apo problemet e ndryshme që lidhen me pasojat nga ndryshimet klimatike.

Në parathënien e këtij botimi (2009) thuhet se: “Që nga botimet e mëparshme të këtij libri (1967, 1983, 2003), historia e klimës së Evropës Perëndimore ka bërë përparim serioz, veçanërisht falë punës së Pierre Alexandre, Christian Pfister, Astrid Ogilvie, Philip Jones, Jan Buisman ose Hervé Le Treut, ndër të tjera. Prandaj e është parë e dobishme, si parathënie për këtë botim të ri, për të dhënë këto konsiderata mbi klimën, të cilat marrin parasysh punë të kohëve të fundit dhe ta shtrijnë reflektimin deri në ditët e sotme”.

#### Nga epoka e bronzit deri në mijëvjeçarin e parë

Nisur nga ideja se kemi rreth dhjetë mijë vjet që jetojmë në një klimë të qëndrueshme, por që kjo klimë është subjekt i luhajtjeve:

### Paleoclimatology

From the glacial periods or the bronze age to the last centuries, in my analysis and based on a series of researches in this book in two volumes, the author Emmanuel Le Roy Ladurie has tried and succeeded in reflecting the climate progress and fluctuations hers, which of course have not passed without impact on the civilizations of the time.

The observed changes in the development of agriculture in different times, the wars, from the medieval climate optimum to the short glacial periods, the end of the last glacial period, and many, many other aspects, where a lot of archaeological information, forests, vineyards are interwoven or historical ones enable

very important assessments and conclusions to judge and analyze on a more accurate scientific basis the progress of the climate in recent years or the various problems related to the consequences of climate change.

At the preface of this new edition (2009) it is mentioned that: “Since the previous editions of this book (1967, 1983, 2003), the history of the climate of Western Europe has made serious progress, in particular thanks to the work of Pierre Alexandre, Christian Pfister, Astrid Ogilvie, Philip Jones, Jan Buisman or Hervé Le Treut, among others. I therefore deemed it useful, as a preface to this new edition, to deliver these

considerations on the climate, which take account of the recent work and extend the reflection to the present day”.

#### From the Bronze Age to the first millennium

Starting from the idea that we have been living in a stable climate for around ten thousand years, but that this climate is subject to fluctuations:





në shkallën e një brezi (rreth tridhjetë vjet), këto luhatje sigurisht që nuk i kalojnë ose nuk arrijnë, 1°C në mesataret shumëdekadale. Rendi i madhësisë do të ishte më mirë gjysmë gradë celsius ose më pak; kjo quhet një stabilitet i caktuar. Megjithatë luhatjet shumë shekullore janë të njohura për ne, ato mbetën për një kohë të gjatë, deri në shekullin e 20-të, në këtë renditje të përmasave ose ndoshta pak më pak, ato janë të njohura për ne për Evropën Perëndimore nga evolucioni i akullnajave të mëdha alpine, veçanërisht në Zvicër me akullnajën e madhe Aletsch dhe disa të tjerë; dhe më pas Chamonix, Francë. Ne marrim kështu alternime, alternime të gjata, midis atyre që quhen “optima” të vogla - faza disa shekullore me klimë pak më të ngrohtë dhe ndoshta më të thatë në varësi të rajonit, klimë e favorshme në çdo rast për prodhimin bujqësor në vende të tilla si Franca ose Italia veriore dhe qendrore. Një optimum i parë i këtij lloji gjendet rreth epokës së bronzit, midis viteve 1500 dhe 1000 para Krishtit. J.-C. A ishte optimumi i epokës së bronzit i favorshëm për fshatarët e rrallë që jetonin në atë kohë? E vështirë për tu thënë. Pastaj kalon një epokë e vogël (e moderuar) akullnajash nga viti 900 deri në 400 para Krishtit. J.-C., epoka e vogël e akullit ose EVA.

## HISTORIA KLIMATIKE QË NGA VITI NJË MIJË

me fjalë të tjera periudha më e ftohtë që ka lidhje me avancimin e akullnajave alpine.

Më pas nga viti 200 p.e.s. para Krishtit deri në vitin 200 pas Krishtit, rreth J.-C., përsëri kemi një optimum: optimumin e vogël romak (OVR), i shenuar disa shekuj më vonë se optimumi i vogël i periudhës së bronzit (OVB). OVR përkon me shekujt më të bukur të Republikës Romake dhe të Perandorisë në prosperitetin e saj, dhe mund të mendohet se edhe atje, ky mot i mirë mjaft i përhapur mund të favorizojë bujqësinë dhe ekonominë republikane atëherë perandorake në përgjithësi.

on the scale of a generation (around thirty years), these fluctuations certainly not exceed, or do not reach, 1°C in the multidecadal averages. The order of magnitude would rather be half a degree centigrade or less; this is called a certain stability. The multisecular fluctuations are nevertheless known to us, they remained for a long time, until

the 20th century, in this order of magnitude or perhaps a little less, they are known to us for Western Europe by the evolution of the great glaciers alpine, especially in Switzerland with the huge Aletsch Glacier and a few others; and then Chamonix, France. We thus obtain alternations, long alternations, between what are called small “optima” - phases of several centuries of slightly warmer and possibly drier climate depending on the region, favorable climate in any case agricultural production in countries like France or northern and central Italy. A first optimum of this kind is found around the Bronze Age, between 1500 and

1000 BC. J.-C. Was this Bronze Age optimum favorable to the sparse peasants who lived at that time? Hard to say. Then a small (moderate) ice age elapses from 900 to 400 BC. J.-C., little ice age or LIA.

## CLIMATE HISTORY SINCE THE YEAR THOUSAND

in other words, cooler period with advance of the alpine glaciers.

Then from 200 BC to 200 AD. Around J.-C., we again have an optimum: the small Roman optimum (SRO), several centuries later than the small bronze optimum (SBO).

The SRO coincides with the most beautiful centuries of the Roman Republic and the Empire in its prosperity, and one can think that there too, this rather widespread good weather could favor agriculture and the republican then imperial economy in general.



Një epokë e re e vogël e akullnajave (EVA) shtrihet midis viteve 270 dhe 600 pas Krishtit. J.-C.: qe përkon me rënien e Perandorisë Romake dhe me pushtimet shkatërruese gjermanike; ku thjesht mund të thuhet, gjë që nuk është shumë larg realitetit, se kjo EVA e re nuk luajti ndonjë rol të veçantë në këtë dobësim zhdukje të mëvonshme të pushtetit romak, të zëvendësuar nga barbarët në pritje të merovingëve.

### **Nga optimumi i vogël mesjetar në epokën e vogël të akullit.**

Shumë më interesant, nga ky këndvështrim, është optimumi i vogël mesjetar i cili shkon nga viti 900 deri në vitin 1300 pas Krishtit. J.-C.

A e favorizoi rritja e lehtë e nxehtësisë në këto data shtytjen e kthjellimeve të mëdha dhe zgjerimin agrar mesjetar? Ka shume te ngjare qe kjo te kete ndodhur deri në kohën e epokës gotike, ndoshta duke e përfshirë dhe ate.

Më në fund arrijmë te EVA e zhvilluar në formën e saj më klasike, me epokën e vogël të akullit që shkon nga viti 1300 në 1860. Gjatë një faze të parë, kjo EVA ka të bëjë veçanërisht me shekullin e 14-të, le të themi nga 1303 deri në 1380.

Akullnajat zvicerane me shtytje të fortë, në veçanti ato të Aletsch dhe Gorner, Aletsch që përparonin herë pas here dyzet metra në vit, e gjithë qenia tregues i dimrave më të ftohtë dhe shpesh me borë, dhe i stineve te verërave, që janë shumë të freskëta dhe me shumë me shi duke bërë dëme dhe kalbur drithërat.

Ishin këto stine vere shumë të freskëta dhe me shumë me shi permbytën disa korrije, përfshirë ato të viteve 1314-1315, duke gjeneruar kështu një nga zitë më të këqija të mesjetës.

Le të përmëdim autorin Baudelaire\*, që e përshkruan këtë periudhë:

*“Kur qielli i ulët, i rëndë, rëndon si kapak,  
Dhe ku horizonti që përqafton gjithë rrethin duke  
na dhënë një ditë të zezë  
më të trishtuar se netët;  
Kur toka shndërrohet në  
një birucë të lagësht,  
ku Shpresa si lakuriq  
nate, Shkon duke u  
përplasur në mure me  
krahët e saj të ndrojtur  
dhe duke përpjekur kokën  
në tavanet e kalbura...”*

*\*Charles Baudelaire - poet  
francez (1821÷1867).*



A new Little Ice Age (LIA) extends between 270 and 600 AD. J.-C.: it coincides with the fall of the Roman Empire and the ruinous Germanic invasions; and one can simply say, which is not very far, that this new LIA did not play any particular role in this weakening then disappearance of the Roman power, replaced by the Barbarians while waiting for the Merovingians.

### **From the small medieval optimum to the small ice age.**

Much more interesting, from this point of view, is the small medieval optimum which runs from 900 to 1300 AD. J.-C.

Did the slight rise in heat on these dates favor the thrust of the great clearings and the medieval agrarian expansion? It is quite similar, and that up to the time of the Gothic age, probably inclusive.

We finally come to the LIA developed in its most classic form, with the little ice age which goes from 1300 to 1860. During a first phase, this LIA concerns more particularly the 14th century, say from 1303 to 1380.

Strong thrust Swiss glaciers, in particular those of Aletsch and Gorner, Aletsch advancing at times by forty meters per year, the whole being indicative of colder and often snowier winters, and of rotten summers harmful to cereals because they are too cool and too rainy.

It was these summers that were too cool and too rainy that drowned out certain harvests, including those of 1314-1315, thus generating one of the worst famines of the Middle Ages.

Let us quote Baudelaire\*, that wrote about such period:

*“When the low heavy sky weighs like a lid,  
And the horizon embracing the whole circle,*

*He pours us a sadder dark  
day than the nights;  
When the earth is changed  
into a damp dungeon,  
Where Hope, like a bat,  
Goes away beating the  
walls with its timid wing  
And banging its head on  
rotten ceilings...”*

*\*Charles Baudelaire –  
French poet (1821÷1867).*

*Përkthyer dhe përshtatur nga gjuha frënge në gjuhën shqipe dhe angleze nga Prof. P. Zorba.*



**“One of the biggest obstacles to making a start on climate change is that it has become a cliché before it has even been understood”**

**Tim Flannery**



**PUT - INSTITUTE OF GEOSCIENCES**

Street: Don Bosko , No.60, Tirana - ALBANIA

Tel: 042 250 601 & Fax: 042 259 540

E-mail: [AlbaniaClimate@gmail.com](mailto:AlbaniaClimate@gmail.com)

Website: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)